

VENDIM
Nr. 97, datë 22.2.2023

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE HUMANITARE NGA KËSHILLI I
MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR MBËSHTETJEN E QEVERISË
SË TURQISË PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA TËRMETI I DATËS 6 SHKURT
2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare humanitare, në shumën 1 000 000 (një milion) euro nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e qeverisë së Turqisë për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 6 shkurt 2023.

2. Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në programin buxhetor 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, llogaria ekonomike 605, t’i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 1 000 000 (një milion) eurosh, për qëllimin sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2023.

4. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punëve e Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku